

**VENDIM**  
**Nr. 90, datë 5.2.2020**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE**  
**PUBLIKE PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2020, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësia përgjegjëse për planifikimin strategjik dhe zhvillimin, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2020.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

## KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2020

| PERIUDHA       | DATA                 | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS              | VEPRIMI PERKATES                                                                                                               |
|----------------|----------------------|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Janar          | 6                    | MoFE                                 | Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHP                                                                                   |
| Janar          | 8                    | KM                                   | Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP                                                                                         |
| Janar          | 13                   | MoFE                                 | Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2021 - 2023                                                                       |
| Janar          | 20                   | KM                                   | Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2021 - 2023                                                                             |
| Shkurt         | 13- 22               | KM                                   | Përgatit dhe miraton projekt dokumentin e prioriteteve të politikave 2021-2023 me ndikim në tavanet buxhetore.                 |
| Shkurt         | 14                   | MoFE                                 | Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2021-2023, për fazën strategjike                                       |
| Shkurt         | 25                   | KM                                   | Shqyrton dhe miraton tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2021-2023, për fazën strategjike                                |
| Shkurt         | 28                   | MoFE                                 | Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.                                            |
| Mars           | 9                    | KM                                   | Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2021-2023                                                     |
| Mars - Prill   | 1 Mars -24 Prill     | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore                                                                                           |
| Prill          | 27 Prill-28 Prill    | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2021-2023                                                           |
| Maj            | 1                    | Njesite e Qeverisjes së Përgjithshme | Paraqesin në MoFE kërkesat e tyre buxhetore                                                                                    |
| Maj            | 4 - 19 Maj           | MoFE                                 | Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore                                                                                         |
| Maj            | 4 - 19 Maj           | KM                                   | Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioriteteve të politikave 2021-2023.                                     |
| Maj            | 20 - 27 Maj          | MoFE                                 | Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme                                                            |
| Maj            | 28-29 Maj            | MoFE                                 | Prezanton dokumentin e PBA 2021-2023 me shoqërinë civile                                                                       |
| Qershor        | 1                    | MoFE                                 | Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i>                               |
| Qershor        | 5                    | KM                                   | Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i>                                     |
| Qershor        | 8                    | KM                                   | Përgatit dhe miraton dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2021-2023 me ndikim në tavanet buxhetore.            |
| Qershor        | 9 -16 Qershor        | MoFE                                 | Përgatit dokumentin e PBA 2021-2023 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2021-2023.                                |
| Qershor        | 22                   | MoFE                                 | Paraqet dokumentin e PBA 2021-2023 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2021-2023, për shqyrtim dhe miratim në KM. |
| Qershor        | 30                   | KM                                   | Miraton dokumentin e PBA 2021-2023 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2021-2023                                   |
| Korrik         | 7                    | MoFE                                 | I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2021-2023                                                                  |
| Korrik         | 8                    | MoFE                                 | Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në fazën teknike,në të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.      |
| Korrik - Gusht | 10 Korrik - 31 Gusht | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.                                            |
| Shtator        | 1                    | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore.                                                                              |
| Shtator        | 2-14 Shtator         | MoFE                                 | Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore                                                                           |
| Shtator        | 2-14 Shtator         | KM                                   | Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2021-2023.                        |
| Shtator        | 15-25 Shtator        | MoFE                                 | Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme                                                            |
| Tetor          | 5-12 Shtator         | MoFE                                 | Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2021 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2021-2023 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.        |
| Tetor          | 15                   | KM                                   | Miraton Projektbuxhetin e vitit 2021 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2021-2023                                            |
| Tetor          | 18                   | MF                                   | Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2021-2023, të miratuar nga KM                     |
| Tetor          | 18                   | KM                                   | I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2021                                                                                |